

1. Pse i gjithë ky polemizim mes muslimanëve sa i përket të folurit të Allahut?

Kjo është prej moti, nuk është prej tash, është prej që kanë dal bidatxhitë në Islam në kohën e imam Ahmetit rahimehullah, kur janë ndikuar prej filozofisë greke e romake dhe kanë futur besime të kota te muslimanët duke devijuar besimin e saktë. Muslimanët kanë qenë të bashkuar sa i përket çështjeve të akides, besimit, nuk kanë pasur defekte, të gjithë kanë besuar në Cilësitë e Allahut dhe se Kurani është Fjalë e Tij. E kur kanë ardhur këta bidatxhi kanë futur këto bidate (risi). Andaj është dashur që ehli suneti t'iu kundërpërgjigjet. Edhe sot e kësaj dite ka njerëz me këto besime të kota që i propagandojnë ato duke thirrur drejt tyre e duke polemizuar rreth tyre, se Kurani nuk është fjalë e Allahut. Çdo sekt i mbesin pas pasardhësit e tij deri në Ditën e Gjykimit. Kështu është kjo gjë, Allahu e ka bërë sprovë për muslimanët. Dhe ne duhet ta dimë besimin e saktë dhe t'iu kundërpërgjigjemi të tjerëve dhe të dimë besimin e kotë të tyre.

Arsyeja pse Allahu e lejon të ndodh ky mospajtim mes muslimanëve është që të kuptohet saktë e vërteta, ngase çdo sekt i dal në Islam i cili e ka kundërshtuar të vërtetën, kështu përmes këtij kundërshtimi është bërë më e qartë e vërteta nga ai aspekt. E kemi kuptuar më saktësisht se çfarë është teuhidi atëherë kur kanë dal njerëz të cilët kanë thirr për në shirk e që janë munduar ta përziejnë me forma që lejohen në Islam, p.sh.: tewesuli (ndërmjetësimi që lejohet) ka argumente të shumta në Kuran e sunet, porse qëllimi këtu është që të bëhet tewesul me Emrat e Allahut dhe Cilësitë e Tij, me veprat e mira, e ata persona kanë dal e kanë thënë që të bëjmë tewesul me pozitën e filanit (duke kërkuar falje e afrim tek Allahu përmes tij), pastaj kanë shkuar dhe më tutje,

e kanë lutur filanin: "O filan i vdekur në këtë varr, o evlia i Allahut, ndërmjetëso për mua tek Allahu!" Dhe kanë thënë se kjo është wesile, Allahu na urdhëron në Kuran të marrim wesile dhe ne po marrim. Dijetarët i janë përgjigjur kësaj e kanë thënë se këto wesile janë të ndaluara, ka prej tyre që e nxerrin njeriun nga feja. Nga ky aspekt e kemi kuptuar më saktë teuhidin e më kthjelltë dhe na është kristalizuar më shumë ai.

Kështu, edhe në këtë rast, kanë ardhur e kanë thënë se Kurani është i krijuar, disa të tjerë kanë thënë se fjalët e Allahut janë kuptim i brendshëm e nuk janë të krijuara, e ndërsa fjalët që i lexojmë apo që i shohim apo që i shqiptojmë janë të krijuara. Dhe kur ne e kuptojmë devijimin e gabimin e tyre në këto çështje dhe kuptojmë se cili është besimi i saktë përmes Kuranit e sunetit, atëherë na bëhet me e qartë se si duhet të kuptohet kjo Cilësi e Allahut, pra të folurit e Tij, dhe se Kurani është Cilësi e Allahut.

Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka lutur Allahun me disa lutje e Ai i është përgjigjur, si: të mos i sprovtojë muslimanët me një armik i cili i çrrënjosë ata (i zhdruk prej faqes së dheut), dhe Allahu e ka pranuar lutjen e tij, andaj dhe muslimanët janë të garantuar prej Allahut nga ky aspekt, e ka lutur gjithashtu që të mos i sprovtojë me thatësi gjithëpërfshirëse prej së cilës vdesin të gjithë muslimanët prej urisë, por kur e ka lutur që të mos lejojë të ketë përçarje mes muslimanëve, Allahu nuk i është përgjigjur. E vërtetë se do të ishte mirë që të gjithë muslimanët të ishin të kapur pas Kuranit e sunetit e të mos ishin të përçarë, por është ligj i Allahut që të ndodhë kjo. Dhe një prej urtësive është që të kuptohet më qartë e më kthjelltë e vërteta.

2. A është sunet falja gjithmonë me këpucë dhe të ngjashme?

Njeriu kur ka mundësi të falet me këpucë, është sunet ta bëjë këtë, dhe kjo ka shpërblim më të madh sesa të falet pa to. Mirëpo, kjo vlen për ambientet ku nuk ka tapetë të shtruar apo ku njerëzit qëndrojnë me këpucë. Në xhamitë e shtruara me tapetë nuk falet namazi me këpucë, por duhet përshtatur vendit dhe ambientit të muslimanëve. Nëse je jashtë dhe do të falesh atëherë më mirë është falja me këpucë (të mos i heq) sesa pa to. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë që hebrenjtë falen pa këpucë e ndërsa ju kundërshtojini ata. Ngjashëm është dhe kur je në shtëpi me papuçe në këmbë, më mirë është falja me to sesa heqja e tyre për t'u falë. Pra, kjo është nëse i ke në këmbë papuçet, e nëse nuk i ke në këmbë por diku më larg atëherë nuk prishë punë të falesh pa to. Qëllimi është që të mos hiqen nga këmba kur do të falesh. Disa mendojnë se sunet është falja pa këpucë, mirëpo kjo nuk është e vërtetë. E kundërta është e vërteta.

3. A lejohet të thuhet "filani i bereqetshëm"?

Thuhet: "Allahu e ka bërë të bereqetshëm". Nëse vërtetë se dikush është i tillë në kuptimin se njerëzit përfitojnë prej tij, prej dijes e thirrjes së tij etj., nuk është problem të thuhet për të "Allahu e ka bërë të bereqetshëm". Porse, në kuptimin se sa herë vjen ai, rritet puna (fitimi) kjo nuk lejohet. Kjo sepse askush nuk është i bereqetshëm në veten e tij, që nëse e prek një dyqan apo mallin atëherë shtohet puna e bereqeti- e ky besim qëndron te sufitë, te dervishët, jo te ehli suneti. Por, në kuptimin se filani kur vjen e lutet për shtim të bereqetit, rrizkut e punës, Allahu i përgjigjet lutjes së tij, lejohet të thuhet "Allahu e ka bërë atë të bereqetshëm sepse sa herë

po lutet po shtohet rrizku", por jo se po shtohet rrizku ngaqë ai po hyn aty fizikisht. Nuk ka njeri të bereqetshëm në veten e tij, fizikisht. I tillë ka qenë vetëm Muhamedi salAllahu alejhi ue selem. Ka qenë i tillë ngase Allahu e ka bërë të bereqetshëm, e jo se ka qenë vetvetiu. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në një rast pasi i ka vendosur duart te pikat e ujit të një burimi (ka rrjedhë pak, pika-pika), Allahu ka bërë që uji të burojë mes gishtave të tij salAllahu alejhi ue selem, sikur krua. Dhe sahabët kanë pirë e kanë mbushur enët e tyre dhe kanë vazhduar rrugëtimin (për në betejën e Tebukut). Ai salAllahu alejhi ue selem në këtë rast u ka u thënë shokëve të tij: ***"Ejani te një ujë i cili është i pastër dhe i bereqetshëm. Ky bereqet është prej Allahut."*** D.m.th. edhe pse prej meje (gishtërinjve të mi) po buron, Allahu është Ai i Cili ma ka dhënë këtë. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka qenë i tillë me mirësinë e Allahut. Askush pas tij nuk është i bereqetshëm në këtë mënyrë. Andaj nuk lejohet të kërkohet bereqet prej dikujt fizikisht siç kanë kërkuar sahabët prej Pejgamberit. Kur ai ka marrë abdes, sahabët kanë garuar me njëri-tjetrin për të marrë ujin me të cilin ka marrë abdes, që të kërkojnë bereqet përmes atij uji. Por, e lejuar ka qenë kërkimi i bereqetit vetëm përmes trupit të Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem dhe gjërave që janë ndarë prej trupit të tij, si: uji i abdesit që ka pikuar prej gjymtyrëve të tij gjatë larjes, pështyma, flokët, qimet e mjekrës, ndërsa përmes gjërave që nuk kanë qenë pjesë të ndara prej trupit të tij sahabët nuk kanë kërkuar bereqet, si: rrobat, këpucët, shkopi.

4. A më priset namazi nëse vetëm dy gishtat e mëdhenj e prekin tokën gjatë bërjes së sexhdes?

Nëse vetëm gishtat e mëdhenj prekin tokën e ndërsa gishtat e tjerë jo, kjo lejohet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "***Jam urdhëruar të bëj sexhde me shtatë gjymtyrë: ballin, hundën, shuplakat e duarve, gjunjët dhe gishtat e këmbëve.***" Dijetarët thonë se nëse një pjesë prej këtyre (çdo) gjymtyrë prek në tokë mjafton dhe është kryer obligimi, p.sh.: nëse prekin vetëm gishtat e mëdhenj (e jo të gjithë gishtat) në tokë gjatë sexhdes obligimi është kryer. Ndërsa, nëse personi fare nuk i lëshon këmbët në tokë (por i mban të ngritura), kjo sexhde nuk i pranohet. Duhet gjithsesi gishtat të prekin në tokë (qoftë dhe disa prej tyre). Nëse një pjesë e një gjymtyrë të sexhdes prek në tokë (dysHEME), obligimi kryhet.

5. A lejohet të theret kurban për të sëmurin që të shërohet ose që të vdesë?

Askund në Kuran a sunet nuk është përmendur ajo që nëse njeriu ther ndonjë kafshë shërohet prej sëmundjes ose vdes. Përderisa nuk ka argumente, atëherë kjo vepër është shirk i vogël. Duhet mësuar një parim, i cili ndihmon shumë sa i përket

shkaqeve se kur janë të lejuara e kur janë të ndaluara, andaj të sqarojmë:

-shkak i lejuar (që lejohet të veprohet) është ai shkak për të cilin Kurani e suneti ka treguar se lejohet të veprohet, p.sh.: lutja tek Allahu, apo dhikri, leximi i Kuranit, hixhamja, pirja e mjaltit apo e farës së zezë etj., -për to ka argumente në Kuran e sunet.

-ose që ka treguar përvoja e profesionistëve të asaj fushe, p.sh.: operacioni, ilaçet etj. Përderisa ata kanë ardhur në përfundim se një ilaç ka efekt, atëherë është shkak i lejuar të veprohet.

Këto shkaqe janë të ligjshme dhe të preferueshme të veprohen kur njeriu ka një lloj sëmundjeje. Nëse nuk është shkak prej këtyre dy llojeve atëherë ndalohet të veprohet, dhe është shirk i vogël ngase për të nuk ka treguar as feja (sheriati) e as përvoja e profesionistëve të asaj fushe.

Sa i përket therjes së Kurbanit, kjo nuk hyn tek asnjëra.

Mirëpo, a lejohet të theret Kurban (një kafshë) në këtë rast për të dhënë lëmoshë, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem në një hadith për të cilin disa dijetarë thonë se është hasen ka thënë: "**Shëroni të sëmurët tuaj me lëmoshë!**" Porse kjo nuk është e specifikuar me therje të kafshës. Çfarëdo lloj lëmoshe, qoftë para, ushqim, apo të

tjera, me lejen e Allahut bëhet shkak që i sëmuri të shërohet dhe për këtë ka argument. Në këtë rast nuk them që të theret kurban një kafshë dhe të shpërndahet si lëmoshë ngase në zemrat e njerëzve ende ekziston kjo bindje (që përmendet në pyetje). Andaj, është mirë që ato pare (që janë caktuar për kurban) të jepen lëmoshë me njetin që Allahu ta shërojë personin. Kjo është diçka me rëndësi, pra bëhet me këtë njet, e lëmosha të llogaritet vetëm si shkak, jo më shumë. Kjo lejohet.

Por, nëse ata besojnë se vetë therja e kurbanit në ato momente, e shëron njeriun ose bën që të vdesë, kjo është shirk i madh, ngase shërimin dhe dhënien jetë e vdekje po ia atribuojnë krijesës, e jo Allahut. Duhet pasur kujdes shumë.

6. A lejohet të thuhet: "Allahu ia lehtësoftë dënimin e varrit", për një të vdekur duke qenë se ai ka vdekur para disa vitesh?

Nuk lejohet për askënd të themi: “Allahu ia lehtësoftë dënimin e varrit”, ngase në këtë mënyrë ti po beson se ai është duke u dënuar, gjë për të cilën ti nuk ke dije. Përderisa nuk ke dije, kjo i bie si një lloj akuze për të vdekurin. Madje, mund të jetë dhe përfolje për të, gjë për të cilën do të japësh llogari para Allahut. Përfolja për të vdekurin është më keq se përfolja për të gjallin, sepse të gjallit shpreson t'ia

kërkosh hallallin, ndërsa të vdekurit nuk mundesh më. Por, duhet thënë: Allahu e mëshiroftë, e faltë, ia bëftë varrin kopsht prej kopshteve të xhenetit, ia ndriçoftë varrin etj.

7. A duhet të dëgjohet fjala Elhamdulillah pas teshtimës për t'i thënë jerhamukAllah?

Ka mospajtime mes dijetarëve për këtë çështje. Porse, mendimi më i saktë është që nëse vërtetohet se ai që teshtinë ka thënë elhamdulillah, atëherë nuk është kusht që të dëgjohet kjo. Qëllimi me hadithin që nëse dëgjon vëllain tuaj të thotë elhamdulillah (pas teshtimes) thoni jerhamukAllah, është vërtetimi se ai ka thënë elhamdulillah. Andaj, nëse në një vend janë mbledhur shumë njerëz e ndërsa njëri në një skaj teshtinë e thotë elhamdulillah, porse për shkak të zërave ata që janë në skajin tjetër nuk arrijnë ta dëgjojnë, por e dëgjojnë ata rreth tij dhe i thonë jerhamukAllah, atëherë i thonë edhe ata të skajit tjetër, ngase është vërtetuar se ka thënë elhamdulillah pas teshtimes.

8. Pse kaq shumë fe kur i njëjti Zot është për të gjithë?

Shumë njerëz kanë një paqartësi të tillë për shkak të mosdijes apo mosnjohurive. Allahu nuk ka ligjësuar

për njerëzit veçse një fe, se si duhet ta njohim e besojmë Allahun. Mirëpo, njerëzit pastaj kanë shpikur fe të tjera, ose fenë që ua ka ligjësuar Allahu e kanë shtrembëruar.

Allahu te popujt e ndryshëm ka ligjësuar dispozita të ndryshme. Çdo Pejgamber (para Muhamedit salAllahu alejhi ue selem) ka qenë i dërguar te populli i tij për një kohë të caktuar. Pastaj ka ardhur Pejgamberi tjetër, e te ndonjë popull ka pasur më shumë se një Pejgamber, kështu ose është vazhduar me të njëjtat ligje ose ka abroguar disa gjëra. Kjo ka qenë sidomos e theksuar te beni Israilët. Allahu atyre vazhdimisht u ka dërguar Pejgamberë, kur ka vdekur një ua ka dërguar një tjetër. Të gjithë Pejgamberët e dërguar tek ta kanë punuar me sheriatin e Profetit Musa, me Tevratin, derisa ka ardhur Isa alejhi ue selem i cili ka sjellë shpallje të re, ligje të reja, të cilat i kanë abroguar (shfuqizuar) disa prej ligjeve që kanë qenë në Tevrat. Kjo ka qenë një prej arsyeve pse Beni Israilët nuk e kanë pranuar Isën si të Dërguar të Allahut. Ata kanë thënë për të se po ua ndryshon fenë e baballarëve të tyre. Inxhili i cili i është zbritur Isës ka qenë shfuqizues i ligjeve të Tevratit dhe ka qenë për një periudhë të caktuar deri sa të vinte Muhamedi salAllahu alejhi ue selem. Kur Allahu e ka dërguar Muhamedin salAllahu alejhi ue selem si të Dërguar, Kurani i ka shfuqizuar të gjitha shpalljet e ligjet e

mëhershme dhe njerëzit e kanë obligim të pasojnë shpalljen e fundit, e jo të mbesin në shpalljet apo ligjet e mëhershme. Kjo sa i përket ligjeve e dispozitave.

E sa i përket çështjeve të besimit, të gjithë Pejgamberët kanë thirrur në një fe: që të adhurohet Allahu i Vetëm dhe të mos i shoqërohet Atij asgjë në adhurim. Mirëpo, pastaj shejtani i ka catur njerëzit dhe i ka devijuar nga kjo rrugë duke i çuar drejt shirkut. Disa kanë adhuruar idhuj (të gdhendur me duart e tyre), disa gurë, disa pemë, disa kanë adhuruar engjëj (siç ka qenë gjendja e mushrikëve të Mekës të cilët engjëjt i kanë konsideruar bija të Allahut, e Ai është i pastër dhe i lartësuar nga ajo që ia kanë mveshur), kanë thënë se duke qenë se janë bija të Allahut janë afër Tij, e ne iu lutemi atyre që të na afrojnë tek Allahu apo që lutjet tona t'ia përcjellin Atij. Disa kanë adhuruar njerëz të devotshëm- Pejgamberë dhe të tjerë, siç është rasti me hebrenjtë të cilët kanë besuar se Uzejri është bir i Zotit dhe e kanë adhuruar, të krishterët e kanë konsideruar si bir të Zotit Isën dhe nënën e tij, e i kanë adhuruar krahas Allahut, e disa prej tyre e adhurojnë edhe Xhibrilin, thonë për të 'shpirti i shenjtë'. E po ashtu adhurojnë dhe shenjtorët e tyre. Sipas tyre, sa herë që një shenjtor vërteton se ka pasur dy mrekulli gjatë jetës, atëherë kisha ose papa e shpallë si të shenjtë dhe pastaj

lejohej që ai të adhurohet. Muhamedi salAllahu alejhi ue selem me shpalljen e fundit ka treguar se të gjitha këto gjëra janë shirk, devijime, shtrembërime, dhe se duhet të adhurohet vetëm Allahu i Vetmi.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe në umetin islam. Kështu njerëzit kanë filluar të adhurojnë njerëzit e devotshëm, prej sahabëve, tabiinëve etj., sidomos prej familjes së të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem. Shumë njerëz kanë kaluar në ekstremizëm dhe i kanë hyjnizuar dhe i kanë adhuruar në vend të Allahut, sidomos Aliun radijAllahu anhu. Madje, disa prej tyre kanë shkuar deri aty sa kanë thënë se Allahu është mëshiruar në Aliun, ashtu siç besojnë (disa nga) të krishterët se Allahu është mishëruar në Isën.

Andaj, arsyeja pse njerëzit kanë kaq shumë fe e degëzime është se vetë ata nuk e kanë pranuar të vërtetën prej Allahut, mirëpo kanë shpikur fe nga vetja apo vetë fenë e Allahut e kanë shtrembëruar apo i kanë dhënë interpretime nga vetja. Porse, Allahu ka garantuar se feja e vërtetë do të mbetet e qartë, triumfuese, me argumentet e saj, deri në Ditën e Gjykimit. Kushdo që e kërkon atë e gjen. Por, njerëzit janë ata të cilët e pengojnë apo e ndalojnë veten e tyre për ta pranuar këtë të vërtetë. Gjithashtu ka dhe arsye të tjera.

9. Marrja e rrobave të një të vdekuri që të digjen e të tymosen fëmijët me to ngaqë janë dembelë në mësim, a është shirk?

Kjo pa dyshim se është shirk, ose shirk i madh ose i vogël. Për ta kuptuar më mirë këtë, sa i përket marrjes së shkaqeve të lejuara, ato janë dy lloje: 1. Ato për të cilat ka folur Kurani e suneti, 2. Ato të cilat i ka vërtetuar përvoja e shkencëtarëve a specialistëve të një fushe. Nëse një gjë nuk është prej këtyre dy llojeve, atëherë veprimi me të si shkak është shirk i vogël. Në Kuran e sunet nuk gjendet argument që të veprohet siç ka ardhur në pyetje. Dembelia ka të bëjë me shkencën, hyn më shumë te psikologjia, e psikologët mohojnë se tymosja e njerëzve dembelë me rrobat e djegura të të vdekurit ndikon për t'i bërë aktiv. Kur dikush vepron kështu duke besuar se kjo gjë është shkak që Allahu ta bëjë një person më aktiv, atëherë ka bërë shirk të vogël. Por, nëse beson se vetë i vdekuri apo rrobat e tij ndikojnë që ta gjallërojnë dhe t'ia largojnë dikujt dembelinë, atëherë kjo është shirk i madh ngase këtu ka barazim të të vdekurit me Allahun, ka besim se i vdekuri mund të krijojë dhe ndikojë krahas Allahut.

10. A lejohet përdorimi i llakut të flokëve?

Llaku bën shtresë mbi flokë. Përderisa bën shtresë mbi qimet e flokëve, atëherë nuk bën përdorimi i tij për dikë i cili do të marrë abdes, ngase kur është duke e fërkuar kokën, nuk është duke fërkuar flokët e tij. Mirëpo, merr abdes e pastaj lejohet të lyejë flokët me të (duke qenë me abdes). Ndërsa, se a bën të fërkohet koka në radhën tjetër, pasi e ka prishur abdesin, ka mospajtime mes dijetarëve. Disa e kanë lejuar ngase Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem kur ka shkuar në haxh dhe ka hyr në ihram, ka lyer flokët me mjaltë, ngaqë haxhi është rrugë e gjatë dhe i shprishen e i pluhurosen, andaj ka përdorë mjaltin. Mirëpo, se sa mund të bëhet analogji mes llakut e mjaltit, kjo është çështje paksa problematike, ngase zakonisht flokët e thithin mjaltin e nuk bëhet shtresë përmbi to, ndërsa llaku mbetet si shtresë. Andaj, të mos përdoret llaku i flokëve përveçse gjatë menstruacioneve (apo lehonisë). Ndërsa, kur janë gjatë kohës së pastërtisë (jashtë menstruacioneve) e përdorin llakun pas marrjes abdes, e kur t'iu prishet abdesi atëherë e largojnë llakun dhe marrin abdes rishtas për namazin e radhës.

11. A është gjë e ndaluar leximi i horoskopit për ta ditur se çfarë po thotë?

Kjo gjë është e ndaluar. Ai që e bën këtë, nuk i pranohet namazi 40 ditë, qoftë nëse e lexon horoskopin në gazeta, në web faqe etj. Kjo është ngjashëm sikur të shkosh te fallxhori e të shikosh se çfarë po thotë për ty. Pejgamberi salAllahu alrjhi ue selem ka thënë se nëse i beson ke mohuar atë që i është zbritur Muhamedit salAllahu alrjhi ue selem, ke bërë kufër, e nëse e lexon vetëm për interesim se çfarë po thotë nuk të pranohet namazi 40 ditë. Besimtari duhet të ketë kujdes dhe duhet që t'i urrejë me zemër këto gjëra. Askush përveç Allahut nuk e di të ardhmen. Kur njeriu ka këtë bindje, këtë besim, atëherë ai e urren çdokënd i cili pretendon se e di të ardhmen, e urren dhe atë që shkruan horoskopin. Nuk ka mundësi që një besimtari, i cili beson Allahun, madhështinë e Tij, Dijen e Tij dhe se Ai e di të ardhmen, t'i shkojë në mendje të lexojë se çfarë po thotë horoskopit. Nëse do ta bënte, kjo tregon për besimin e tij të dobët dhe se nuk e ka frikë Allahun me frikë të denjë.

12. A lejohet që surja Kehf të lexohet me xhemat, secili pjesë-pjesë?

Të lexohet surja Kehf bashkërisht (me xhemat) kjo nuk ka bazë në sunetin e Pejgamberit salAllahu

alejhi ue selem e as në traditën e sahabëve. Secili e lexon vetë suren Kehf. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "***Kush e lexon suren Kehf në ditën e xhumah do t'i bëhet dritë mes dy xhumave.***" Secili nga familja duhet ta lexojë vetë dhe ta arrijë këtë shpërblim të ardhur në hadith. Në një hadith thuhet: "***Kush e lexon suren Kehf në ditën e xhumah do t'i bëhet dritë mes dy xhumave.***" Në një tjetër transmetim thotë: "***Kush e lexon ditën apo natën e xhumasë...***" Andaj, nuk ka të keqe të lexohet edhe në natën e xhumasë, e jo vetëm ditën e xhuma. Ka ardhur si vepër e sahabëve se e kanë lexuar ditën e xhuma.

13. A është gjë e ndaluar marrja e kredisë për të ndërtuar shtëpi?

Dijetarët e mëdhenj, të gjithë, kanë dhënë përgjigje se kredia është kamatë. Si e tillë, ajo është e ndaluar. Nuk lejohet të merret kredi për asgjë, ngase kamata është e ndaluar në veten e saj. Allahu ka treguar se e ka asgjësuar bereqetin prej kamatës. Nuk ka bereqet prej asaj pasurie që fitohet me kamatë. Shtëpia nuk lejohet të ndërtohet me kamatë për arsye sepse njeriu ka mundësi të jetojë edhe me qera dhe me këtë e kryen nevojën për strehim. Shtëpia

nuk është domosdoshmëri. Në Islam ekziston rregulli: domosdoshmëria i bën të lejuara gjërat e ndaluara. Nuk është gjithsesi e domosdoshme që njeriu të ketë një shtëpi pronë të tij. Ka njerëz në botë që lindin e vdesin duke jetuar me qera, pa pasur kurrë një shtëpi si pronë të tyre. Te populli jonë qëndron ideja që njeriu të ketë shtëpi të tij, por nuk është gjithsesi e domosdoshme kjo gjë. Duke qenë se nuk është e domosdoshme atëherë nuk lejohet të merret kamatë. Disa dijetarë thonë se për kamatë s'ka domosdoshmëri, e disa thonë se ajo lejohet vetëm atëherë kur është puna për bukën e gojës, pra kur njeriu është në rrezik të vdesë nga uria atëherë në këtë rast i lejohet.

14. Kur lexohet surja Mulk?

Surja Mulk lexohet prej kur perëndon dielli (hyn akshami) deri në hyrjen e kohës së sabahut. Kështu, kurdo që e lexon (brenda kësaj kohe) e zbaton sunetin profetik. E nuk është çështja, sikur është keqkuptuar, që ajo duhet të lexohet para se të biem për të fjetur. Pejgamberi salAllahu ka thënë që të lexohet gjatë natës. Mirëpo, është mirë të lexohet para se të bie në gjumë për arsye se nëse njeriu fle, është rrezik të mos i dal më gjumi dhe kështu

mbetet pa lexuar suren Mulk, ose ndodhë të flejë dhe harron ta lexojë. Gjithashtu dhe surja sexhde dhe dy ajetet e fundit të sures Bekare, kurdo që lexohen gjatë natë kjo është në rregull. Mirëpo, këto dy ajete është mirë të lexohen sa më herët d.m.th. pasi që hyn akshami. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë se kush i lexon gjatë natës i mjaftojnë. I mjaftojnë d.m.th. për t'u mbrojtur nga të këqijat. Andaj është mirë që besimtari t'i lexojë këto dy ajete sa më parë (pasi hyn akshami) duke arritur me këtë mjaftueshmërinë e përmendur në hadith apo mbrojtjen prej të këqijave.

15. Në këto ditë pandemie po dalin materiale me përmbajtje konspirative dhe preh e tyre po bien vetë muslimanit, të cilët po i shpërndajnë pa hezitim. Një këshillë!

Bazë në fe është mospërhapja e lajmeve pa i konfirmuar. Allahu thotë: **"O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë)..."** Huxhurat 6. Ky ajet bën fjalë për një musliman mëkatar, e mos të flasim për atë se lajmet që marrim na vijnë prej jobesimtarëve, apo prej sufive e

sekteve, apo prej personave që pretendojnë se dinë çfarë ndodhë në botë, për marrëveshjet e fshehta, planet etj., dhe pastaj i plasojnë në mesin e muslimanëve, duke u bërë këta nga të parët që i pranojnë ato. Kjo është në kundërshtim me fenë. Nuk lejohet pranimi i një lajmi pa qenë i konfirmuar. E konfirmimi i tij është gjë e pamundur sepse burimi i atij lajmi nuk dihet. Kur i pyet: "A e ke burimin e lajmit?", të referon te ndonjë emër që është i dyshimtë për shkak të besimit të tij, apo mendimeve të tij, apo nuk është prej ehli sunetit etj. E vetë ky pastaj nuk tregon se nga e ka marrë, por thjeshtë e jep si lajm. Të përhapet çdo gjë që lexohet në internet, kjo nuk bën dhe ka pasoja të shumta. Te dikush mund të shkaktojë frikë, panik, përçarje etj. Teoritë konspirative, muslimani nuk duhet t'i besojë menjëherë pa u konfirmuar ato. Se a mund të konfirmohen, kjo është e pamundur, për arsye se vetë ata që i nxjerrin këto teori kanë deklaruar se do të nxjerrin aq shumë teori sa njerëzve do t'iu humbet fija e lëmshit dhe nuk do ta dinë se cila është vërteta e cila e rrejshmja. Këto teori dikush i shpikë qëllimisht, që të mbjellë konfuzion e mëdyshje se çfarë të besojnë njerëzit dhe frikë ndër ta. Andaj, muslimani në këto çështje duhet t'i

mbështetet Allahut, të marrë mësimet e Tij dhe të Pejgamberit e t'i praktikojë në jetën e përditshme, dhe me lejen e Allahut nuk e dëmton asgjë. Kur vepron me atë që e ka mësuar Allahu dhe Pejgamberi i Tij, asgjë nuk mund ta dëmtojë, përveç nëse Ai lejon dikë apo diçka ta dëmtojë. Këto teori e plane kanë qenë gjithmonë gjatë historisë, por kur muslimanët u janë përmbajtur udhëzimeve të Kuranit e sunetit, nuk janë dëmtuar nga intrigat. Muslimani duhet të ketë kujdes të mos bie viktimë e këtyre lajmeve dhe të mos i pranojë aq lehtë, por duhet shumë të ketë kujdes dhe të mos e marrë një lajmë përveçse atëherë kur konfirmohet qartësisht si fakt e dëshmi.

Hoxhë Lulzim Perçuku - Derset live.